

Dalës-izlazonë

Nr. 11-1278

Data 17.12.2018

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI

Br. 11-1278
I mbledhjes së VI-të të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Obiliqit, të mbajtur më 07.12.2018 në ora 10:00 , në sallën e KK-së.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë:, Komandanti i SP-Sejdi Zeqiri, përfaq. i FSK-major I.Demiri, perf.i BIK-B.Mjekiqi, përfaq.i komun.ortod. Naspaliq Aleksander, përfaq.kom.serb.- Slavisha Jakovljeviq, përfaq.i komun.boshnjak-Lejla Boshnjak, drejtor i DMM-Arben Berisha, drejtori i DA -Agim Spahiu, Kryetari i KLSP- sekt.I-re-Burim Gërguri, përfaq. i Kësh.të prind.-Fatmir Bërbatovci, përfaq.kom.rom-Shaban Berisha, zyrtari i emergj.-Valon Berisha, Qendra Rinore-Zelushe Kelmendi, Eljesa Tërbunja-Handikos, EVSB-Sejdi Haxholli, OJQ "Aureola"- Sanije Graiçevci, ZKKK- Sllavisha Agjanqiq, Kryetar i K. Komunitete-Avdyl Mustafa, përfaq.i kom.malaz.-Jasmina Radanoviq, zyrt.baraz.gjinor-Ganimete Aliu dhe koordinator i KKSBB - S. Hashani.

Mungoi: Kryetari i Komunës-Xhafer Gashi

Prezent të tjerë: përfaqësues të KFOR-it dhe OSBE-së

Mbledhjen e KKSBB-së, e udhëhoqi Nënkryetari Komunës –Arben Berisha, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se ka kuorum për të filluar mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Obiliqit
4. Të ndryshme

Kryesuesi- Pasi i përshëndeti të pranishmit i njoftoi se Kryetari i Komunës gjendet ne objektin e TC –Kosova B, së bashku me Kryeministrin e Kosovës z.Ramush Haradinaj. Pas kësaj kalohet në r.d. i cili u aprovua njëzëri.

I. Pika e parë e rendit të ditës.

Mungoi : Kryetari i Komunës-Xhafer Gashi

II. Pika e dytë e rendit të ditës-

Pasi nuk pat vërejtje nga të pranishmit njëzëri:

Aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

III. Pika e tretë e rendit të ditës-

Komandanti i SP-S.Zeqiri- të pranishmit i njoftoi se situata e sigurisë në Komunën e Obiliqit është relativisht e qetë. Jemi në hetim të rastit ne fshatin Lajthishtë ne shkollën fillore F.Graiçevci. S'bashku me zyrtarët e QPS-së janë intervistuar nxënësit dhe akterët tjerë. Kemi konstatuar se rrahja ka ndodhur dhe jemi duke e proceduar kallximin penal, ku prokurori i rastit me vendim do të procedoj rastin në prokurori. Ndërsa DAK-ja duhet te ndërrmarin masat sipas procedurave te veta.

-Me rastin e Ditës së "28 Nëntor"-it, Ambasada e Shqipërisë ka organizuar një eviment në Amazonë,
- po ne këtë ditë te pllaka përkujtimore ne qytet kemi pasur një sulëm ndaj personit zyrtar, rasti është në procedurë,

-kemi një planë operativ rreth çështjes së plaçkitjeve që është ngritur edhe në Prishtinë,

-para dy ditëve Kryeministri i Kosovës e ka vizituar fshatin Plemetin me rastin e përrurimit të rrugës, dhe ka qenë i ftuar në shtëpinë e Nënkrjetarit për Komunitete, z. S.Jakovljeviq. Por pas dy ditëve Nënkrjetari ka marr mesazhe kërcënuese,

- dhe në fund i njoftoj të pranishmit se sot Kryeministri gjindet ne TC-Kosova A, dhe se duhet te shkoj për shkak te obligimeve,

A.Berisha- tha se sa i përket kërcënimeve ndaj z.Jakovljeviqit, edhe ne e ngrisim zërin për mbështetjen e tij.

Pas kësaj Komandanti u lirua nga mbledhja për shkak të agjendës.

IV. Të ndryshme-


E.Tërbunja- e paraqiti shqetësimin e tij për shkak të pirjes së duhanit nëpër lokale dhe propozoj qe te veproji inspeksioni dhe te zbatoj ligjin.

A.Berisha- tha se do të bisedohet me inspektorët qe te veprojnë ne këtë drejtim.

OSBE-Gazmend Pirraj- tha se e përgëzon komunën për realizimin e 6 mbledhjeve brenda vitit dhe se jeni komuna e parë që e plotësoni këtë kriter.

Takimi përfundoi në ora 10:20.

Koordinatorë-Procesmbajtës
S. Hashani



Kryesuesi i KKSB-së
Xhafer Gashi

